

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me sekretaren juridike Minire Krasniqi, ne ceshtjen juridiko-kontestimore te inicuar me padine e paditeses K.S. '██████████' me seli në Prishtinë Qyteza Pejton rr.'██████████' nr.██, kundër të paditurit ██████████ nga fsh ██████████ Komuna Ferizaj, për çështjen juridike rimbursim dëmi, jashte séance me date 17.07.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

-PER SHKAK TE PADEGJUESHMERISE/MOSBINDJES-

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses K.S. '██████████' me seli në Prishtinë Qyteza Pejton rr.'██████████' nr.██ si e bazuar.

DETYROHET i padituri ██████████ nga fsh ██████████ Komuna Ferizaj, qe paditëses t'ia paguan shumën prej 854.00€, me kamat ligjore nga dita e paraqitjes se padisë e deri ne pagesen definitive, si dhe taksën gjyqësore për përpilimin e këtij aktgjykimi ne shumë prej 20€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit, me pretendimin se per shkak te veprimeve deliktore te te paditurit gjate pjesemarrjes ne komunikacion, ka shkaktuar aksident trafiku dhe ka shkaktuar deme per te cilin paditsja eshte detyruar qe ta kompensoj te palen e tretë, pasi qe i padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk ka poseduar patentë shofer (leje të vozitjes), andaj në bazë të ligjit mbi autopërgjegjësin e njejta kërkon rimbursimin e dëmit të paguar palëve të treta.

Paditesja, gjykatës i kanë bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera material, per kompensimin e palës së dëmtuar respektivisht kompensimin e dëmit materiale, nga ky aksident trafiku.

Gjykata, te paditurit me datë 30.04.2018, i ka dorezuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditësit, por i paditurit brenda afatit të caktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, nuk kanë ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tij nëse e kundërshtojnë apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si dhe duke pasur parasysh faktin se i padituri ka pranuar me rregull padine me prova dhe aktvendimin per pergjigje ne padi, gjykata bazuar ne nenin 150.6 te LPK-së ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjygjëse.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 te LPK-së, që përjashton mundësin për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur ne bazë të nenit 277 te LMD-se, duke qenë se për paditësin lartësia e borxhit, ka qenë e përcaktuar që në kohën e ngritjes së padisë.

Gjykata ka obliguar të paditurin për kompensimin e shpenzimeve te procedures kontestimore ne baze te nenit 452.1 te LPK-se, ndërsa paditësin në bazë të UA nr.01/2017 te KGJK-se, për unifikiminë e taksave gjyqesore.


GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.327/18, me datë 17.07.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVO

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më 31.07.2018 20 18
Dana

 Gjyqtari,
Enes Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh ne gjykatën e Apelit ne Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme e pranimit te këtij aktgjykimi.